

# MPRA

Munich Personal RePEc Archive

## **The Banking System in Kosovo and its Role in Economic Development**

Govori, Florije

26 January 2009

Online at <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/24536/>  
MPRA Paper No. 24536, posted 23 Aug 2010 19:53 UTC

# **Sistemi Bankar në Kosovë dhe Roli i tij në Zhvillimin Ekonomik**

Në skemën e riaftësimit të rrjetës së infrastrukturës për ngritjen e ekonomisë kosovare, përfshihej edhe ngritja e institucioneve financiare ndër të cilat ABPK (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës). Ky autoritet me status të veçantë kishte për qëllim sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm monetar i cili do të përkujdesej për pagesat e brendshme, likuiditetin, solventitetin dhe funksionimin efikas të sistemit bankar në Kosovë<sup>1</sup>.

Në ngritjen e sistemit financiar mendohet të jenë aplikuar praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Struktura institucionale është e larmishme si: Banka Komerciale, Kompani të Sigurimit, Fonde të Pensioneve, Institucione Mikrofinanciare, Asociacione Kreditore dhe Institucione Financiare Jobankare, të licencuara dhe të mbikqyrura nga ABPK<sup>2</sup>.

## **Institucionet financiare - Bankat Komerciale**

Për një periudhë relativisht të shkurtër, institucionet financiare shënuan zhvillim të hovshëm. Bankat Komerciale mbuluan gjithë territorin e Kosovës. Përderisa ato vendore zgjerorin rrjetin e korrespondimit me bankat e jashtme, dy bankat me kapital të jashtëm futën produktet e reja bankare si ATM, E-bankingun dhe terminale POS.

Depozitat kishin një rritje vjetore mesatarisht prej 20% dhe përbënin burimin kryesor të mjeteve në këto institucione. Sa i përket kreditimit të sektorëve jofinanciar, edhe pse është shënuar rritje e dukshme tri vitet e fundit, përqindja e rritjes vjetore në bilancin e bankave nuk ka tejkaluar ndryshimin prej 7%.

Përkundër arritjeve të mëdha në këtë sektor për një periudhë të shkurtër, bankat

---

<sup>1</sup> Një program për rindërtimin dhe rimëkëmbjen në Kosovë, Nëntor 1999. Përgatitur nga Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe Kombet e Bashkuara në Kosovë.


<sup>2</sup> Tani BQK.

komerciale vendore u përballën me sfida të reja, duke marr parasysh kufizimet në aftësitë menaxhuese për ndërtimin dhe zhvillimin e strategjive operuese, ndjekjen e produkteve të reja dhe gjithsesi uljen dhe kontrollin e shpenzimeve të administrimit, si kusht për mbijetesën e tyre<sup>3</sup>.

### Indikatorët e Bankave Komerciale në Kosovë

Përgjatë kësaj periudhe, normat e interesit të paguara për depozita ishin të ulta krahasuar me normat e interesit në huatë e dhëna nga bankat komerciale. Deri në vitin 2004 normat e interesit nuk shënojnë ndonjë ndryshim të madh. Pas këtij viti kishte lëvizje në të dy drejtimet, por në interesin e huave bankare vërehen paqëndrueshmëri më të mëdha.<sup>4</sup>

**Diagrami 1. NI në Bankat Komerciale**



Burimi: AQBK

Diferenca e gjerë e realizuar ndërmjet interesit të paguar në depozita dhe interesit të marr nga huatë përgjatë kësaj periudhe, krijoi një korridor mjaft të levërdishëm për bankat (Diagrami 1). Ky korridor jo vetëm që mbulonte shpenzimet e larta të bankave, por siguronte edhe norma kthimi atraktive të cilat tejkalonin mesataren e

<sup>3</sup> Ndërkohë një bankë falimentoi dhe dy të tjera u blenë nga banka të jashtme. Kjo bëri që të ndryshojë edhe struktura e kapitalit të bankave komerciale që vepronë në vend.

<sup>4</sup> Këto variacione janë përlogaritur dhe prezantuar si mesatare për periudhen 2001-2007 edhe në Tabelën 1.

rajonit për 36%, dhe mesataren e Evropës Perëndimore për 50%. Norma e kthimit në kapital tejkalon mesataren e top pesëdhjetë bankave më të mëdha evropiane për 30%. Neto marxhina e interesit është tri herë më e lartë se mesatarja evropiane, ndërsa shpenzimet (duke përjashtuar ato të interesit në depozita) qëndrojnë me 50% mbi mesataren e bankave komerciale në Gjermani.

**Tabela 1. Gjerësia e variacionit në normat e interesit në vend dhe eurozonë<sup>5</sup>**

	Në vend	Në eurozonë
Gj V –interesi në depozita	1.3	0.49
Gj V – interesi në kredi	1.52	0.38
Gj V – ndërmjet <i>i</i> në depozita dhe <i>i</i> në kredi	13.8	1.9
$\sigma^2$ – interesi në depozita	0.213	0.025
$\sigma^2$ – interesi në kredi	0.47	1.5

Sa i përket konkurrencës brenda sektorit bankar, ajo ekzistonte në cilësinë e shërbimeve por jo edhe në çmime. Disa nga bankat vendore humbën hapin dhe u blenë nga banka të jashtme.

### **Cili ishte roli i këtyre institucioneve në ekonominë kosovare dhe sa u përmbushën nevojat reale për zhvillimin ekonomik dhe financiar të qëndueshëm?**

Huatë bankare përgjatë kësaj periudhe përbënin 20 deri 24% të BPV që ishte e ultë krahasuar me vendet tjera (në vendet në zhvillim kjo përqindje arrin deri 75%, ndërsa në vendet e zhvilluara tejkalon 160%). Këto hua ishin përqendruar kryesisht në sektorin e tregtisë, hotelierisë, turizmit dhe shërbime të tjera me 84%. Industria e cila konsiderohet të jetë gjeneruese e zhvillimit ekonomik përbënte 13%, dhe agrikultura 3%. Ndërsa, aktiviteti kreditor i ndërmjetësve të tjerë financiarë si: Institucionet Mikrofinanciare, Asociacionet Kreditore dhe Institucionet tjera financiare jobankare arrinte 2,6% të BPV. Pjesëmarrja në kreditimin e gjithmbarshëm arrinte 12.6%. Kreditimi nga këto institucione kryesisht është bërë


<sup>5</sup> Vlerat janë kalkuluar nga të dhënat e publikuara në raportet e AQBK dhe ECB.

në sektorin bujqësor, prodhues dhe sektorë në biznese të vogla. Normat e interesit në këto kredi sillen ndërmjet 10% deri 24%.

Kushtet e huave të ofruara nga bankat të cilat karakterizohen me norma të larta interesi dhe afate të shkurtëra kthimi, ishin të papërballueshme për shumicën e bizneseve të mesme dhe të vogla. Normat e larta të interesit dhe afatet e shkurtëra të kthimit arsyetoheshin me pasiguritë që e shoqëronin tregun kosovar. Por ato shpejtë u bënë një pengesë serioze për rritjen e bizneseve ekzistuese dhe ngurrim për ndërmarrësi të reja në këtë fushë.

---

**Diagrami 2. Struktura e kredive bankare**



Burimi: AQBK (Raporte vjetore)

---

Një mungesë e madhe e sistemit financiar përgjatë këtyre viteve ishte mosprania e bankave të specializuara për kreditimin e fushave të caktuara ekonomike. Kur merret parasysh gjerësia dhe thellësia e njohurive në fusha përkatëse, prezenca e institucioneve bankave të specializuara do të ndihmonte në alokim më efikas të mjeteve në veprimtari profitabile në degë të caktuara të ekonomisë (me interes të veçantë do të ishte sektori prodhues), dhe gjithsesi në rritjen e konkurrencës brenda sistemit bankar.

## **Referenca**

Raporti vjetor 2004 Prishtinë, Maj 2005, ABPK.

Raporti vjetor 2005 Prishtinë, Maj 2006, ABPK.

Raporti vjetor 2006 Prishtinë, Maj 2007, ABPK.

Annual Report 2007, ECB.

Raporti vjetor 2007 Prishtinë, Maj 2008, AQBK.

Bilten, MFRM, 2006.

Deutsche Bundesbank, Monatsbericht Stand vom 11.2004, 2007.

ECB statistics-an overview, April 2008.

Monthly Bulletin, 12-2007, ECB.

World Economic and Financial Surveys-Global Financial Stability Report Market Developments and Issues, 2007.